



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë 09/02/2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjan, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 08.02.2021, të parashtruar nga **Grup i Operatorëve Ekonomik AOME SH.P.K.; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, Gjeravica, 10000, KOLOVICE, Kosovë** të dt. lidhur me aktivitetin e **Furnizimi i të gjitha shkollave me dru zjarri-Kontratë kornizë, 613-20-6243-1-1-1. i brenshëm i prokurim 613-20-121-1-1-1**

V E N D I M

I. Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e **Grup i Operatorëve Ekonomik AOME SH.P.K.; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, Gjeravica, 10000, KOLOVICE, Kosovë** të dt. 08/02/2021 lidhur me aktivitetin e **Furnizimi i të gjitha shkollave me dru zjarri-Kontratë kornizë, 613-20-6243-1-1-1**

II. Vërtetohet Vendimi i AK për shpërblim me kontratë, Operatori Ekonomik NTP "Agoniti" Prishtinë, i datës 02/02/2021 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.

III. betet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 02/02/2021

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik AOME SH.P.K.; Ndërmarrje Tregtare Shërbyese TINI, Gjeravica, 10000, KOLOVICE, Kosovë të dt. 08/02/2021 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit lidhur me aktivitetin e **Furnizimi i të gjitha shkollave me dru zjarri-Kontratë kornizë**, nr. prokurimit **613-20-6243-1-1-1**, ku ne kete aktivitet te prokurimt, Autoritet Kontraktues ka shpallur fitues NTP "Agoniti" Prishtinë, më datë 02/02/2021 te publikuar ne platformen elektronike e-prokurimi.

Autoriteti Kontraktues, me datë 09/02/2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pretendimi juaj

Pretendimi se ju jeni eliminuar pa të drejtë nuk qëndron, sepse nuk i plotësoni kushtet e paraqitura në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit, arsyet i keni në letrën standarde por duhet t'i përsërisim dhe t'i qartësojmë edhe disa detale që Ju në pretendimin e juaj i keni përzi (me qëllim apo pa qëllim nuk mund ta themi).

Në njoftimin për kontratë :

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 300 000.00 euro. **Ne rast te grupit, lideri duhet t'i kete se paku 60 % te shumës se kërkuar furnizime te natyres se njejtë**

Operatori Ekonomik AOME SH.P.K.; lider i grupit nuk ka ofrua dëshmi se ka referenca te natyrës së njëjtë në vlerë prej **180,000.00 €**

Pretendimi se ju e keni ofrua këtë shumë shihet shumë qartë se ne listën e kontratave të realizuar **për furnizime të njëjta furnizim me dru** ju keni ofrua shumën prej **151,773.70 €** që dmth. se nuk e plotësoni kriterin e kërkuar.

Gjatë vlerësimit por edhe gjatë rivlerësimit të dokumentacionit të juaj, komisionet kanë vërejtur se për kontratat e paraqitura në listë, nuk keni ofrua dëshmi se i keni përfunduar ato kontrata sepse nuk keni pasë referenca siç është kërkuar në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.

Komisioni për rivlerësim me letër standarde, për këtë ka kërkuar sqarim, dmth ju ka ofruar mundësinë që të ofroni dëshmi se i keni përfundua ato kontrata që i keni paraqitë në listën e kontratave gjatë ofertimit. Siç shifet dhe nga skjarimet që janë dhënë në letrën standarde, për tenderuesin e eliminuar, ju keni dështuar të ofroni dëshmi se i keni përfundua me sukses kontratat që i keni paraqitë në listën e kontratave te realizuara gjatë 3 viteve të fundit para publikimit të njoftimit për kontratë, e këtë e keni pranuar edhe vetë në kërkesën për rishqyrtim siq është rasti:

1.Kontrata "Furnizimi me dru per ngrohje për te gjitha institucionet e KK Novo Berde" me nr.pr.654-2020-011-121 , e cila nuk është pranua **per arsye se kjo kontratë është ne realizim e siper**, që don të thot se kjo kontratë **përfundon me date 18.05.2021**, në këtë rast ju deklaroheni se kjo është një gabim teknik por tani ne mendojmë se ju me qëllim keni tentua që Autoritetin kontraktues ta veni në lajthitje.

Gjithashtu pretendimet e juaja në kërkesën për sqarim nuk qëndrojnë se juve nga lista e kontratave të paraqitura (prej 13 Kontratve) **nuk iu janë pranuar vetëm 4 kontrata. Por kërkesa juaj është hartuar në atë mënyrë që të krijoj huti në opinion për ata që nuk i shtjellojnë me kujdes pretendimet e juaja.**

Siq u cek më lartë nuk është pranuar kontrata:

1. Kontrata "Furnizimi me dru per ngrohje per te gjitha institucionet e KK Novo Berde" me nr.pr.654-2020-011-121 për arsyet e cekura më lartë,
2. Kontrata "Furnizimi me lëndë djegëse dru për ngrohje" me Kompanin Regjionale "Uniteti" me nr.prok.20-5513-1-3-6 keni sjelle reference cila është pa date kur është lëshuar, edhe pse kemi kërkuar informata sqaruese ju nuk keni arrit te dëshmoni se këto furnizime i keni përfunduar para datës se hapjes se ofertave 23.11.2020
3. Kontrata "Furnizimi me dru bungu dhe ahu per ngrohje" AK Univerziteti "Ukshin Hoti" Prizeren keni sjelle reference e cila mban date **24.11.2020** e cila është pas hapjes se ofertave nga AK Komuna e Lipjanit (shih daten e hapjes 23.11.2020).
4. Kontrata "Furnizimi me lende djegëse drunore për ngrohjen e objekteve KRU Bifurkacioni" Ferizaj me nr.prok. 20-5267-136, **referenca e datës 14.12.2020** është pas datës se hapjes se ofertave nga AK Komuna Lipjan shih daten e hapjes 23.11.2020).

Pretendimi pika 1 dhe 2 se nuk janë pranuar referencat për kontratën me titull: Furnizimi i zyrave postare ne regjion (dru) zjarri për djegje për sezonin 2018/2019 e nr prokurimit PK-18-39-136 dhe kontratën me titull: Furnizimi me dru për shkolla me nr prokurimit KKHE-029/2019-136, nuk qëndron sepse siq u cekë më lartë edhe në letrën standarde nuk janë pranuar vetëm kontratat që janë cekë në letrën standarde

Sa i përket pikes katër. Kontrata "Furnizimi me dru bung dhe ahu per ngrohje" AK "Univerziteti "Ukshin Hoti" Prizeren pretendimi se datë është protokolluar gabim këtë ne nuk mund ta dimë ne i referohemi vetëm asaj që shkruan e në këtë rast siq është skjaruar edhe më lartë nuk mund të pranohet si e tillë pretendimi se këtë **referencë e keni të ngarkuar me rastin e ofertimit nuk është e vërtetë**, por këtë referencë e keni ngarkuar pas kërkesës nga Autoriteti kontraktues për informata shitesë që dmth edhe këtu dëshironi të na shtyni prap në lajthite.

Siq shihet nga ato që shkruan më lartë oferta e juaj nuk e plotëson kushtin: **III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 300 000.00 euro. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar **furnizime te natyres se njejtë** sepse lideri nuk ka referenca për **furnizime të njëjta** në vlerë prej 180,000.00€ edhe sikur t'i pranohen të gjitha kontratat e paraqitura në listë, prap ju nuk plotësoni kriterin prej 180,000.00 € ashtu siq kërkohet nga lideri i grupit (60 % te shumës së kërkuar për furnizime të natyrës së njejtë), por ju po mundoheni që me deklaratave jo të vërteta të na bindni se keni të drejtë.**

AK, konsideron se tenderi juaj është vlersuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

